



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

implemented by:
**inter
cooperation**

Natural Resource Management
Rural Economy
Local Governance and Civil Society

Swiss – Kosovo

Local Governance and Decentralization Support

LOGOS



Prezentim i buxhetit komunal për vitin 2011

Komuna e KLLOKOTIT

LOGOS



Ky prezentim është përgaditur nga RECURA Financials
për projektin LOGOS të implementuar nga Intercooperation

Maj 2011

RECURA Financials

Address: Nëna Terezë 28/1, 10000 Prishtina, Kosovo

tel: +381 (0)38 777 800, Fax: +381 (0) 38 22 14 14 ; cel: +386(0)49 160 049; 777 800

info@recura.biz - www.recura.biz

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL	4
ZYRA E KRYETARIT	7
ASAMBLEJA KOMUNALE.....	7
ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL	9
SHËRBIMET PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA	9
BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL.....	11
KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI.....	11
SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE	13
ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI	13
INVESTIMET KAPITALE	15


HYRJE

Ky dokument është një përmbledhje e buxhetit komunal për vitin 2011, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky dokument nuk është dokument zyrtar komunal dhe paraqet një përmbledhje të buxhetit të përgaditur nga projekti LOGOS me qëllim të informimit sa më të mirë dhe përfshirjes sa më të madhe të qytetarëve në procesin buxhetor në komunë.

Dokumenti përmban një kategorizim të buxhetit sipas drejtorive dhe kategorive të shpenzimeve si dhe listën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara nga komuna për vitin 2011.

PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL

Kllokot - 660	
PASQYRE E PERGJITHSHME E BUXHETIT	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	855,745.00
INVESTIMET KAPITALE	211,446.00
PAGAT DHE MEDITJET	557,534.00
Pagat - Administrata Komunale	270,857.00
Pagat Arsimi	221,615.00
Pagat Shendetesia	65,062.00
MALLRA DHE SHERBIME	71,108.00
Administrata Komunale	40,608.00
Arsimi	17,500.00
Shendetesia	13,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	10,500.00
Administrata Komunale	10,500.00
Arsimi	0.00
Shendetesia	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	5,157.00
Administrata Komunale	5,157.00
Arsimi	0.00
Shendetesia	0.00



Për vitin 2011, komuna e Kllkotit është planifikuar të ketë në dispoicion 855,745 Euro, nga të cilat Qeveria ka ndarë 847,355 Euro, ndërsa komuna planifikon të realizojë të hyra vetanake në vlerë prej 8,390 Euro.

Siç mund të shihet nga tabela përmbledhëse, nga ky buxhet, 211,446 Euro janë ndarë për projekte të investimeve kapitale në komunën e Vitisë.

Pagat dhe mëditjet e planifikuara kapin vlerën prej 557,534 Euro, nga të cilat shpenuesi më i madh është administrata komunale me 270,857 Euro, derisa sektori i arsimit dhe kulturës ka të buxhetuara 221,615 Euro ndërsa shëndetësia 65,062 Euro për paga. Pagat janë të llogaritura në vlerë bruto përfshi edhe të gjitha tatimet dhe kontributet.

Shpenuesi i tretë buxhetor për nga madhësia është kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ku për komunën e Kllkotit janë planifikuar 71,108 Euro, ku shpenzuesit më të mëdhenj janë administrata dhe sektori i arsimit.

Shërbimet komunale kapin vlerën prej 10,500 Euro, të cilat plotësisht janë të dedikuara për administratën komunale.

Subvencionet dhe transferet janë në nivel prej 5,157 Euro, nga të cilat administrata komunale paraqet shpenzuesin e vetëm të buxhetuar.



ZYRA E KRYETARIT

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
ZYRA E KRYETARIT	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	57,431.00
PAGAT DHE MEDITJET	42,274.00
Numri i stafit	7
MALLRA DHE SHERBIME	10,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	5,157.00

Nga zyra e Kryetarit të Komunës paraqiten shifrat prej 42,274 Euro, të cilat shfrytëzohen për të paguar stafin dhe mëditjet e Zyres, që në vitin 2011 planifikohet të jenë gjithsej 7 vetë, me një pagë mesatare mujore (përfshi mëditjet) prej 503.24 Euro. Zyra e kryetarit ka të buxhetuara 10 ,000 Euro për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe 5,157 Euro për subvencione dhe transfere.

ASAMBLEJA KOMUNALE

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
ASAMBLEJA KOMUNALE	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	56,930.00
PAGAT DHE MEDITJET	52,930.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	
MALLRA DHE SHERBIME	4,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Asambleja e Komunës së Kllokotit poashtu ka një shpenzim shumë të koncentruar dhe ate shumicën ne paga dhe mëditje për asambleistët në vlerë prej 52,930 Euro. Pjesa e mbetur prej 4,000 Euro është e paraparë për mallra dhe shërbime.



ADMINISTRATA DHE PERSONELI KOMUNAL


KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
ADMINISTRATA (Administrata dhe Personeli, Buxheti dhe Financat, Zyra e komuniteteve)	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	151,074.00
PAGAT DHE MEDITJET	126,466.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	31
MALLRA DHE SHERBIME	14,108.00
SHERBIMET KOMUNALE	10,500.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Në këtë linjë buxhetore janë të përfshirë drejtoritë e administratës dhe personelit, buxhetit dhe financave, Zhvillimit Ekonomik, zyra e komuniteteve si dhe prokurimi, me gjithësej 31 të punësuar. Buxheti total për shpenzimet e administratës komunale është 151,074 Euro, nga të cilat 126,466 Euro janë të dedikuara për paga dhe mëditje, me një pagë mesatare mujore prej 340 Eurosh. Mallrat dhe shërbimet janë të llogaritura në vlerë prej 14,108 Eurosh, derisa shpenzimet komunale me 10,500 Euro.

SHËRBIMET PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMEREGJNCA

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	22,388.00
PAGAT DHE MEDITJET	19,388.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	6
MALLRA DHE SHERBIME	3,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Shërbimet e përgjithshme publike dhe emergjencat kanë një buxhet prej 22,388 Eurosh, prej të cilave një pjesë e madhe është e dedikuar për paga dhe mëditje, 19,388 Euro. Me një staf prej 6 vetësh, paga mesatare mujore për këtë drejtori është 269.3 Euro. Për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për këtë drejtori janë ndarë 3,000 Euro.



BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	10,660.00
PAGAT DHE MEDITJET	8,160.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	2
MALLRA DHE SHERBIME	2,500.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Drejtorja për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural ka një staf prej 2 vetësh dhe një buxhet vjetor prej 10,660 Euro. Paga mesatare që marrin shërbyesit civil në këtë drejtori (përfshi mëditjet) është 340 Euro për muaj. Një shumë është e dedikuar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 2,500 Euro.

KADASTRA E PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot – 660	
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	28,639.00
PAGAT DHE MEDITJET	21,639.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	5
MALLRA DHE SHERBIME	7,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00

Drejtorja e Kadastrës si dhe ajo e Planifikimit urban dhe e mjedisit punëson një staf prej total 5 vetësh me pagë mesatare prej 360.65 Euro dhe me një buxhet total vjetor prej 28,639 Euro.



SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
Shendetesia dhe Mireqenia Sociale	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	78,062.00
PAGAT DHE MEDITJET	65,062.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	15
MALLRA DHE SHERBIME	13,000.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00
SHPENZIMET KAPITALE	0.00

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale është njëra nga dy kategoritë specifike buxhetore, të cilat marrin grant (buxhet) të posaçshëm nga qeveria dhe poashtu është një nga drejtoritë me buxhet më të lartë. Për vitin 2011 për shëndetësi dhe mirëqenie social janë ndarë 78,062 Euro. Nga këto 65,062 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për punëtorët e këtij sektori (15 sish), të cilët marrin një pagë mesatare prej 361.45 Euro për muaj. Edhe kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime është e lartë pasi ka shpenime direkte në mallra dhe për vitin 2011 kap vlerën prej 13,000 Euro. Për vitin 2011 nuk janë paraparë investime kapitale në sektorin e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

ARSIMI, KULTURA, RINIA DHE SPORTI

KOMUNA:	TOTAL
Kllokot - 660	
Arsimi, Kultura, Rinia dhe Sporti	
Viti 2011	
TOTALI I BUXHETIT	321,388.00
PAGAT DHE MEDITJET	221,615.00
Numri i Anetareve dhe Stafit	58
MALLRA DHE SHERBIME	17,500.00
SHERBIMET KOMUNALE	0.00
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	0.00
SHPENZIMET KAPITALE	82,273.00

Sektori i arsimit është shpenzuesi më i madh buxhetor në komunën e Kllokotit me një buxhet të planifikuar prej 321,388 Eurosh. Nga këto, 221,615 Euro janë të ndara për paga dhe mëditje për 58 punëtorët e arsimit, me një pagë mesatare mujore prej 318.41 Euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë buxhetuar me 17,500 Euro. Shpenimet kapitale të parapara për këtë sektor në vitin 2011 kapin vlerën prej 82,273 Euro.




INVESTIMET KAPITALE

Këtu përfshihen të gjitha investimet kapitale të planifikuara nga komuna e Kllokotit, me përjashtim të investimeve kapitale në shëndetësi dhe arsim, të cilat janë të llogaritura në kuadër të këtyre dy sektorëve. Totali i planifikuar i investimeve kapitale (me përjashtim të shëndetësisë dhe arsimit) për vitin 2011 është 129,173 Euro, të planifikuara për realizimin e projektit të asfaltimit të rrugëve dhe trotuarave të komunës së Kllokotit.

Është me rëndësi të theksohet se projektet kapitale, sikurse i gjithë buxheti, i nënshtrohen një rishikimi në gjysmë të vitit dhe mund të pësojnë ndryshime. Ky proces i revidimit është shumë i rëndësishëm dhe pjesëmarrja e qytetarëve është shumë e rëndësishme.

	KOMUNA:	TOTAL
	Kllokot - 660	
	Viti 2011	
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE (PA ARSIMIN DHE SHENDETESINE)	129,173.00
1	Asfaltimi irrugëve dhe trotuareve në Kllokot	129,173



Nazim Gafurri str. 33
Po Box no.2
10000 Pristina, Kosovo
<http://www.intercoopkos.org/logos>

Tel: +381(0) 38 51 77 15
Tel: +381(0) 38 51 66 44
Fax: +381(0) 38 51 88 33
info@intercoopkos.org